



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

# **Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi TM4 2018 (2015=100)**



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

## Parathënie

Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK) përkatësisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit ka filluar grumbullimin e të dhënave për çmimet e inputeve bujqësore në nëntor të vitit 2003. Në fillim, numri i artikujve ishte i kufizuar. Me ndërrimin e vitit bazik nga viti 2003 në vitin bazik 2005, në 2010=100 është rrit edhe numri i inputeve (nga 15 në 23 inpute). Aktualisht grumbullohen çmimet për 77 inpute të ndryshme bujqësore.

Ky është publikimi i dyzetë (40) mbi Indeksit e çmimeve të inputeve dhe Çmimet mesatare absolute të inputeve bujqësore përgatitur nga Agjencioni i Statistikës së Kosovës. Në këtë publikim, janë paraqitur Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet për disa inpute kryesore bujqësore.

ASK-ja falënderon Agjencionin Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Kooperim (SIDA) për mbështetjen e tyre për ndërtimin e sistemit të statistikave agromonetare. ASK-ja, gjithashtu falënderon të gjithë bashkëpunëtorët e zyrave rajonale të ASK për bashkëpunim, , respondentët për ofrimin e të dhënave: fermat bujqësore, ndërmarrjet industriale dhe tregtare, etj.

Në veçanti, ASK-ja falënderon ekspertët suedezë të statistikave të çmimeve, z. Anders Grönvall dhe të tjerët, që në mënyrë të drejtpërdrejtë a indirekte ndihmuan në finalizimin e këtij publikimi

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim mund t'i dërgoni në email adresën e departamentit: **agriculture@rks-gov.net**

Publikimin e përgatitën:

Bajrush Qevani – Drejtor i departamentit,

Violeta Arifi – Gashi – Shefe e divizionit,

Kademsha Bajramaga – Zyrtare

Shkurt 2019, Prishtinë

Kryeshef Ekzekutiv i ASK

Isa Krasniqi

## Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencioni i Statistikës së Kosovës
IÇIIB	-	Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi
BE	-	Bashkësia Evropiane
SIDA	-	Agjencioni Ndërkombëtarë i Suedisë për Zhvillim dhe Kooperim
TM4	-	Tremujori i katërt
‰	-	Promil

Në tabelat ku janë dhënë peshat numrat janë rrumbullakuar deri në shifrën e fundit më të afërt për këtë arsye mund të ketë një mospërputhje të lehtë të shumave.

## **P ë r m b a j t j a**

Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore.....	4
Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore TM4 2015-2018 (2015=100 ).....	5
Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore tetor – dhjetor 2018, (2015=100) .....	6
Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore tetor – dhjetor 2018 , (2015 = 100) .....	6
Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore tetor – dhjetor 2018/2017(2015=100) .	7
Metodologjia .....	8
Pyetësori.....	9

## Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore

Të dhënat e prezantuara në këtë publikim përfshijnë të dhëna për indeksin prej muajit tetor deri në dhjetor të vitit 2018 (2015=100) që mbulon periudhën 2015-2018. Për të bërë krahasime dhe për të vërejtur ndryshimet janë prezantuar të dhëna për tremujoret e katërt (TM4) të viteve 2015-2018 me vitin bazik 2015, (2015 =100)

Publikimi bazohet në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinarë, në kompani , tregje dhe vende tjera ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit (CPI) nga ASK.

ASK-ja ka bërë ndërrimin e vitit bazik nga 2010=100 në 2015=100 sipas metodologjisë së Eurostatit.


Produktet të cilat e përbëjnë bazën për Indeksin e çmimit të inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2). Brenda grupit të Mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues, energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinarin, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime tjera. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje tjera), ndërtesat dhe tjera (ndërtesat jo-rezidente të fermës, punët tjera përveç përmirësimit të tokës).

Grafiku 1 tregon Indeksin e tremujorit të katërt të inputeve nga 2015 – 2018 për Inputet në përgjithësi si dhe për Inputet 1 dhe Inputet 2 (2015 = 100).

### Ndryshimet e indeksit të tremujorit të katërt në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 (ndryshimi në %)

Indeksi i tremujorit të katërt të inputeve në vitin 2018 ka rënie për (-0.2 %) për **Input 1** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Indeksi për **Input 2** ka rritje për (1.7 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Indeksi i inputit të përgjithshëm (**Input 1 +Input 2**) ka rritje për ( 0.7 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017.

### Grafiku 1: Indeksi TM4 i çmimeve të inputeve 2015 – 2018, (2015 = 100)



**Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore TM4 2015-2018 (2015=100)****Tabela 1: Indeksi i Çmimeve të inputeve bujqësore TM4 2015-2018, (2015=100)****Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)**

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		TM4 2015	TM4 2016	TM4 2017	TM4 2018
		%	1000 Euro				
<b>200000</b>	<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)</b>	<b>556</b>	<b>126 490</b>	<b>102,2</b>	<b>96,5</b>	<b>94,4</b>	<b>94,2</b>
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	91	20 777	116,0	86,0	<b>83,6</b>	<b>74,2</b>
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	103	23 433	98,6	100,2	101,0	111,0
202100	Energjia elektrike	17	4 637	109,6	111,9	105,9	95,6
202300	Lëndë djegëse	137	17 480	95,3	97,6	100,4	116,5
202400	Lubrifikant	3	1 316	104,2	93,0	92,6	92,6
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	149	33 958	100,1	95,0	88,4	85,5
203100	Plehrat e thjesht	56	12 777	98,7	91,3	87,1	82,5
203200	Plehrat e përbëra	93	21 181	100,9	97,2	89,2	87,3
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	23	5 137	96,9	104,2	102,9	106,3
205000	SHPENZIMET VETERINARE	38	8 732	99,5	99,3	96,9	98,2
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	3	741	106,3	102,9	105,8	103,4
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	104	630	108,2	104,1	105,2	102,7
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	12	111	95,3	96,1	109,7	107,5
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	48	10 883	99,9	99,5	99,8	99,4
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	4	833	100,1	97,5	98,8	98,7
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	97	21 996	99,8	100,1	100,5	101,0

**Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)**

<b>210000</b>	<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)</b>	<b>444</b>	<b>100 971</b>	<b>102,8</b>	<b>102,4</b>	<b>103,5</b>	<b>105,3</b>
211210	TRAKTOR	208	47 375	105,8	<b>107,2</b>	<b>108,2</b>	<b>110,8</b>
211290	TJERA	236	53 596	100,2	98,1	99,4	100,4

**Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)**

<b>220000</b>	<b>INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)</b>	<b>1 000</b>	<b>227 461</b>	<b>102,5</b>	<b>99,1</b>	<b>98,4</b>	<b>99,1</b>
---------------	---	--------------	----------------	--------------	-------------	-------------	-------------

## Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore tetor – dhjetor 2018, (2015=100)

Tabela 2: Indeksi mujor i çmimeve të inputeve bujqësore tetor – dhjetor 2018 , (2015 = 100)

<b>Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)</b>						
Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		2018		
		%	1000 Euro	Tet	Nën	Dhj
<b>200000</b>	<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)</b>	<b>556</b>	<b>126 490</b>	<b>94,2</b>	<b>94,0</b>	<b>94,3</b>
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	91	20 777	74,4	74,0	74,1
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	103	23 433	111,9	111,9	109,4
202100	Energjia elektrike	17	4 637	95,6	95,6	95,6
202300	Lëndë djegëse	137	17 480	117,7	117,6	114,2
202400	Lubrifikant	3	1 316	92,6	92,6	92,6
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	149	33 958	84,9	84,5	86,9
203100	Plehrat e thjesht	56	12 777	82,9	81,2	83,3
203200	Plehrat e përbëra	93	21 181	86,2	86,5	89,1
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	23	5 137	106,3	106,3	106,3
205000	SHPENZIMET VETERINARE	38	8 732	98,2	98,2	98,2
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	3	741	101,9	102,0	106,4
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	104	630	100,9	101,1	106,2
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	12	111	107,3	107,3	107,8
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	48	10 883	99,4	99,4	99,4
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	4	833	98,7	98,7	98,7
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	97	21 996	101,1	101,0	101,0
<b>Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)</b>						
<b>210000</b>	<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)</b>	<b>444</b>	<b>100 971</b>	<b>104,7</b>	<b>105,7</b>	<b>107,0</b>
211210	TRAKTOR	208	47 375	108,5	110,7	113,3
211290	TJERA	236	53 596	101,3	101,3	101,4
<b>Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)</b>						
220000	INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)	1 000	227 461	98,9	99,2	99,9

## Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore tetor – dhjetor 2018/2017(2015=100 )

Tabela 3: Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore tetor – dhjetor 2018 / 2017 (2015= 100)

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	Pesha		Tet 18/ Tet 17 Ndrysh. në %	Nën 18/Nën 17 Ndrysh. në %	Dhj 18/Dhj 17 Ndrysh në %
		%	1000 Euro			
<b>200000</b>	<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)</b>	<b>556</b>	<b>126 490</b>	<b>-0,1</b>	<b>-0,3</b>	<b>-0,1</b>
201000	FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES	91	20 777	-11,0	-11,4	-11,3
202000	ENERGJI; LUBRIFIKANT	103	23 433	10,9	10,8	8,1
202100	Energjia elektrike	17	4 637	-9,6	-9,6	-9,6
202300	Lëndë djegëse	137	17 480	17,4	17,2	13,7
202400	Lubrifikant	3	1 316	0,0	0,0	0,0
203000	PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS	149	33 958	-4,1	-4,3	-1,6
203100	Plehrat e thjesht	56	12 777	-4,9	-6,7	-4,4
203200	Plehrat e përbëra	93	21 181	-3,6	-2,8	0,0
204000	PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET	23	5 137	3,3	3,4	3,4
205000	SHPENZIMET VETERINARE	38	8 732	1,3	1,3	1,3
206000	LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH	3	741	-0,8	-4,2	-1,7
206100	Lëndë të thjeshta ushqimi	104	630	-0,6	-4,6	-1,7
206200	Lëndë të përbëra ushqimi	12	111	-2,2	-2,2	-1,8
207000	MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE	48	10 883	0,1	-0,5	-0,5
208000	MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE	4	833	0,2	-0,3	-0,2
209000	MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA	97	21 996	0,6	0,5	0,6
<b>Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)</b>						
<b>210000</b>	<b>MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)</b>	<b>444</b>	<b>100 971</b>	<b>0,5</b>	<b>1,2</b>	<b>2,5</b>
211210	TRAKTOR	208	47 375	0,3	2,3	4,8
211290	TJERA	236	53 596	0,6	0,2	0,3
<b>Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)</b>						
<b>220000</b>	<b>INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)</b>	<b>1 000</b>	<b>227 461</b>	<b>0,1</b>	<b>0,4</b>	<b>1,1</b>



## Metodologjia

Çmimet dhe indekset e çmimeve në këtë publikim janë kalkuluar sipas standardeve për statistikat e çmimeve të Bashkimit Evropian. Projekti për kalkulimin e këtyre çmimeve dhe indekseve të çmimeve është realizuar brenda projektit për “Përmirësimin e statistikave agromonetare” në bashkëpunim me Statistikat Suedeze dhe me mbështetjen financiare nga SIDA (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar).

Çmimet janë grumbulluar në shtatë regjione: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Çmimet janë grumbulluar çdo muaj rreth datës 15. Që nga fillimi numri i artikujve për të cilët janë grumbulluar çmimet është rritur hap pas hapi.

Qëllimi i Indeksit të çmimit të inputeve bujqësore është përcjellja e çmimeve të blerjes të mjeteve për prodhim bujqësor. Sipas definicionit, indeksi nuk i mbulon faktorët e prodhimit. Rrjedhimisht, rogat dhe kostoja e rrogave, qiraja, pagesa e kamatës, blerja e tokës dhe kafshët si asete fikse nuk janë pjesë e fushë-vëzhgimit.

Për të krahasuar indeksin e BE-së të paraqitur në këtë publikim me shtetet tjera, rekomandohet faqja elektronike e Eurostat-it (<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/eurostat/home>).

Peshat për kalkulimin e indekseve të agreguara kryesisht janë bazuar në Llogaritjet ekonomike bujqësore 2015, që është viti bazë në indeks (2015=100). Këto peshat janë fikse përderisa baza e indeksit është viti 2015. Indeksi është indeks i çmimit dhe kalkulohet bazuar në formulën e *Laspeyres*.

### Llogaritja e indeksit elementar të çmimit

Llogaritja e indekseve elementare është bërë në përgjithësi duke përdorur formulat në vijim, me çmim mesatar aritmetik të papeshuar.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^o} \cdot 100$$

$R_i^t$  – Indeksi elementar për muajin t dhe prodhimin i

P – Çmimi i grumbulluar

i – Prodhimi i

j – Çmimi j i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për regjionin)

t – Muaji i vëzhguar

0 – Muaji bazë

### Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimit

Llogaritja e indeksit të agreguar për totalin e inputeve ose nëngrupeve të indeksit të inputeve është bërë duke shfrytëzuar formulën në vijim.

$$I^t = \sum \left( R_i^t \cdot \frac{w_i^0}{\sum w_i^0} \right)$$

$I^t$  - Indeksi i agreguar për periudhën t

$w_i^0$  - Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin i

i - Prodhimi i

t - Muaji i vëzhguar

0 - Muaji bazë

## Pyetëtori

DEFINICIONI -Përcaktimi i cakt (artikujve- vareteteve)

Numri i artikullit	Emri i artikullit			Sasia	Njësia
	Grumbulluesi i çmimit			Vendi i grumbullimit / Ndërmarrja	
Data					
Çmimi					

### Shënimet e anketuesve

- Përshkrimi hollësishëm i artikullit (varietetit) specifik të zgjedhur për monitorim të çmimit
- Ndryshimet në përshkrimin e hollësishëm, data e ndryshimeve
- Trajtimi i ndryshimit të kualitetit kur përshkrimi është ndryshuar ( informacionet e vrojtmeve të dyfishta të çmimit, plotësuese dhe vlerësimi i ndryshimit të kualitetit)

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 155 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruet terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informatat të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** [infoask@rks-qov.net](mailto:infoask@rks-qov.net)
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>